 <b>REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT</b> <b>NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE</b>			
DATE: PËRZËNDARIT DORËZUAR: DATUM: PRIMEJEN DOSTAVLJEN: DATE RECEIVED SUBMITTER:			
Nivela Org. Org. Jedin Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
06	47	1789	9



No. Br. No. <u>535</u>		Nr. Str. No. <u>1</u>
Data/Gesha/Date <u>22 07 2020</u>		PRISHINE-PRISTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada-Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrasnji Poslova**  
**Ministry of Internal Affairs**

Për Zyren Kombëtare të Auditimit  
 Nga z. Agim Veliu, Ministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Titulli i auditimit: " Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike "

Nr.	Gjetja/titulli	Rekomandimi	Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit/Zyrtari/ët përgjegjës	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Koha/Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1.	ASHI-ja nuk ka strategji të miratuar për qeverisje elektronike për sektorin publik, <i>shih faqe 7</i> .  Institucionet e Republikës së Kosovës-IRK nuk kanë strategji të TI-së:	<b>Rekomandimi nr: 2</b>  Të siguroj se, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në koordinim me të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, duhet të hartojnë strategjinë për qeverisje elektronike dhe planin e veprimit për zbatim si dhe të përcaktojnë qartë objektivat dhe prioritetet strategjike. Kjo strategji duhet të shërbej si mjet për zvogëlimin e	ASHI-Kujtim Gashi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga ASHI	K4 / 2021
			DASK-Artan Dreshaj	<b>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga DASK:</b>  MPB në varësi të strukturës së re organizative që do ta krijoj pas procesit të bashkimit të dy	

	<p>-MPB nuk ka strategji të IT-së, <i>shih faqe 8</i>;</p> <p>-ARC nuk ka strategji të IT-së, <i>shih faqe 8</i>.</p>	shpenzimeve, përmirësimin e shërbimeve, kursimin e kohës, kursimin e resurseve dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit në sektorin publik.		<p>ministrive, do të krijoj strategjinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve (TIK).</p> <p>DASK e ka vendosur në plan të punës për vitin 2020, hartimin e strategjisë për TIK, mirëpo pas procesit të bashkimit të dy ministrive, në varësi të procesit të krijimit të strukturës së re të MPB-së, vlerësojmë që nuk do të mund të realizohet ky aktivitet gjatë vitit 2020.</p>	Viti 2020/2021
			ARC-Genç Hamzaj	<p><b>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga ARC:</b></p> <p>Konform rekomandimit, ARC gjatë këtij viti do të bëjë hartimin e Strategjisë së TI-se e cila do të jetë në koordinim të plotë me strategjinë e ASHI-se dhe konform kornizës aktuale ligjore. Gjithashtu, do të hartohet plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie.</p>	
2.	ASHI-ja ka vështirësi në përmbushjen e detyrave të saj dhe në plotësimin e pozitave profesionale, <i>shih faqe 10</i> .	<p><b>Rekomandimi nr: 4</b></p> <p>Në koordinim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, duhet të plotësoj pozitat të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi që ka ASHI-ja, si dhe për arritjen e objektivave të qeverisjes elektronike.</p>	ASHI-Fujtim Gashi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga ASHI:	
3.	Në MF dhe MPB detyrat dhe përgjegjësitë për menaxhimin e teknologjisë	<p><b>Rekomandimi nr: 14</b></p> <p>Të bëjnë centralizimin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit nëpër</p>	DASK-Artan Dreshaj	<b>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga DASK:</b>	

	së informacionit janë të dyfishuara, <i>shih faqe 10-11.</i>	institucione në harmoni me kornizën ligjore në fuqi si dhe brenda departamenteve/ekipeve në një institucion, për të mundur arritjen e objektivave të institucioneve me shërbime cilësore, si dhe për të mundur zvogëlimin e rrezikut, kostove financiare dhe kohore.		Në strukturën e re organizative dhe rregulloren e re për organizimin e MPB-së, do të adresohet kjo e gjetur.	
			ARC-Genc Hamzaj	<p><b>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga ARC:</b></p> <p>Konform rekomandimit dhe konform kornizës ligjore në fuqi, do të qartësohen përgjegjësitë për menaxhimin e TI-se bazuar në: RREGULLOREN (QRK) NR. 01/2020 PËR STANDARDET E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM, SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS DHE BASHKËPUNIMIN NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE AGJENCITË E PAVARURA.</p>	<b>Viti 2020</b>
4.	ASHI-ja nuk bën monitorimin e duhur të IRK-ve për zbatimin e standardeve dhe politikave të TI-së dhe promovimin e shërbimeve, <i>shih faqe 11.</i>	<b>Rekomandimi nr: 5</b> Në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, krijon mekanizma për monitorimin e zbatimit të standardeve, politikave dhe procedurave të qeverisjes elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, si dhe të sigurohet që këta mekanizma hartojnë raporte mbi nivelin e zbatimit të këtyre standardeve, politikave dhe procedurave.	ASHI-Kujtim Gashi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga ASHI.	



	<p>në fushën e TI-së, <i>shih faqe 13-14.</i></p>	<p>informacionit, për gjendjen ekzistuese dhe kërkesat e reja të nevojshme që ndihmojnë në arritjen e objektivave të organizatave.</p>	<p>DASK-Artan Dreshaj</p>	<p>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga DASK:</p>	<p>Viti 2020/2021</p>
			<p>ARC-Genc Hamzaj</p>	<p>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga ARC:</p> <p>Konform rekomandimit dhe kornizës ligjore ne fuqi, ARC do te siguroje listën e regjistrave te shpenzimeve dhe investimeve te TI-se te projekteve ekzistuese dhe projekteve te reja qe do te realizohen ne te ardhmen.</p>	
<p>7.</p>	<p>MPB-ja për investimet në teknologji të informacionit-pajisjet harduerike printer-fotokopje skaner nuk ka bërë analizë të fizibilitetit dhe kost-benefitit. <i>shih faqe 17;</i></p> <p>MPB-ja ka bërë shpenzime të cilat nuk i shtojnë vlerë zhvillimit të sistemeve informative, <i>shih faqe 18;</i></p>	<p><b>Rekomandimi nr: 7</b></p> <p>Të siguroj që në zhvillimin e projekteve që financohen nga donatorët, zyrtarët e ministrisë/organizatës të jenë pjesë e ekipit të menaxhimit të projektit, në vazhdimësi të monitorohet zbatimi i projektit dhe të vlerësohet me qëllim të arritjes së objektivës së projektit;</p> <p><b>Rekomandimi nr: 8</b></p> <p>Të siguroj se para pranimit dhe futjes në funksion të sistemeve informative, të realizohen të gjitha testet e pranueshmërisë për të vlerësuar që sistemet janë në</p>	<p>DASK-Artan Dreshaj</p>	<p>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga DASK:</p> <p>Siç është sqaruar edhe në komentet e dërguara gjatë procesit të auditimit, gjatë vitit 2019 është realizua një analizë e këtyre kontratave dhe është vlerësua që pas përfundimit të kontratave të lidhura nga MPB, nuk do të inicohen procedurat për lidhje të kontratave të reja por do të shfrytëzohet kontrata nga AQP. Kjo do të vazhdoj në këtë mënyrë përveq në rastet eventuale kur MPB mund të autorizohet nga AQP.</p> <p>DASK do të kujdeset që gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike, të mos lejohet blerja e pajisjeve të tilla pa arsyeshmërinë dhe aprovim nga ana e departamentit që paraqet kërkesën. Nëse blerja e pajisjeve të tilla si “telefona të</p>	<p>K3/2020</p>

	<p>Është krijuar varësi ndaj Operatorit Ekonomik duke rrezikuar vazhdimësinë e sistemit RIMS36 në kuadër të MPB-së, <i>shih faqe 18</i>;</p>	<p>pajtueshmëri me kërkesat e institucionit.</p> <p><b>Rekomandimi nr: 6</b></p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe Agjencia për Regjistrimin Civil, në procesin e identifikimit të kërkesave të nevojshme për investimet në fushën e teknologjisë së informacionit, të definojë qartë kërkesat e nevojshme të përdoruesve dhe të krijojë mekanizma adekuat për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave para fazës së tenderit.</p>		<p>mençur” konsiderohet e domosdoshme, do të kërkohet aprovim paraprak më shkrim nga departamenti përgjegjës duke njoftuar edhe Sekretarin e përgjithshëm të MPB-së.</p> <p>Blerja e kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera që janë në përgjegjësi të AQP-së do të bëhet nga AQP, përveq në rastet kur AQP nuk mund ta kryej një procedurë të tillë dhe autorizon MPB-në për lidhje të kontratës dhe furnizim më pajisje.</p> <p>Sistemi RIMS ka qenë donacion nga Ambasada Amerikane, dhe ka filluar të zhvillohet në vitin 2013. Sisteme të ngjashme në atë kohë janë zhvillu edhe në Policinë e Kosovës dhe në Doganën e Kosovës.</p> <p>Në kohën e zhvillimit të sistemit RIMS shumica e sistemeve që sot përdoren nuk kanë qenë të zhvilluara apo nuk i kanë pasur funksionet e sistemit RIMS. Sistemi RIMS si i tillë mundëson menaxhim të integruar të të gjitha shërbimeve të brendshme ku përfshihen.</p> <p>Ambasada Amerikane kur e ka kontraktua sistemin RIMS e ka kontraktua pa kodin burimor dhe si të tillë MPB nuk e ka në dispozicion.</p> <p>Në MPB ekzistojnë edhe sisteme të tjera ku MPB nuk është pronare e kodit burimore.</p> <p>MPB është institucioni i parë dhe i vetëm në Republikën e Kosovës që pas një analize të zhvilluar, ka përgatitur specifikat teknike dhe ka lidhur kontratë të mirëmbajtjes dhe avancimit për sistemin e DSHAM që nuk e posedon kodin</p>	<p><b>K4/2020 – K2/2021</b></p>
--	--	---	--	---	---------------------------------


				<p>burimor ku shërbimet e mirëmbajtjes dhe avancimit të atij sistemit, paguhen në orë pune.</p> <p>Kostoja mujore e mirëmbajtjes së sistemit të DSHAM në krahasim me kontratën e kaluar është rreth 60 % më e ulët.</p> <p>Kostoja e avancimit dhe mirëmbajtjes sipas kësaj kontrate, është shumë më e ulët se sa kostot e kontratave të lidhura për avancim dhe mirëmbajtje të sistemeve, me procedura të hapura, marr parasysh se ky sistem është ndër sistemet më të rëndësishme në MPB që ka qenë edhe njëri ndër kushtet kryesore gjatë procesit të liberalizimit të vizave.</p> <p>Sa i përket sistemit RIMS, ne edhe në takime me zyrtaret e ZKA i kemi theksua që varësisht nga rrjedhat e kontratës së DSHAM, për të cilën nuk e kemi pasur kodin burimor, do të veprojmë edhe me sistemin RIMS, më qenë se për shërbimet ditore të punës, stafi i DASK e ka mirëmbajtur dhe administruar sistemin pa problem, mirëpo nëse nevojiten ndryshime brenda sistemit, në mungesë të kodit burimor, kjo është e pamundur të bëhet.</p> <p>Pas bashkimit të MAP me MPB-në, do të analizojmë veprimet që do të ndërmarrim për të ardhmen, duke u bazua edhe në strukturën e re të MPB-së që do të krijohet.</p>	
--	--	--	--	---	--



	<p>Sistemi Informativ "SACONS" i zhvilluar për Departamentin për Siguri Publike, është funksionalizuar pa u bërë pranimin teknik, <i>shih faqe 19;</i></p> <p>ARC-ja nuk ka bërë analizë të mirëfilltë të gjendjes aktuale dhe nevojave për zhvillim, blerje dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe pajisjeve harduerike, <i>shih faqe 19;</i></p>		<p>ARC-Genc Hamzaj</p>	<p>DASK do të kujdeset që pa pranim teknik të sistemeve, të mos lejohet futja në funksion e sistemeve informative që jipen nga donatorët. Njëherit do të njoftoj të gjithë donatorët me këto rekomandime në fazat fillestare të projektit dhe do të angazhohet në ekipin për menaxhim të projektit nga fazat fillestare të projektit.</p> <p>Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë nga ARC:</p> <p>Konform rekomandimit, ARC konfirmon qe për projektet e ardhme nga fusha e TI-se, do te definohen qarte kërkesat e nevojshme dhe do te krijohen mekanizmat adekuat për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave para fazës se tenderit përmes krijimit te grupeve punuese për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave dhe kërkesave.</p>	<p><b>Rekomandimet do të fillojn të zhatohen menjëher.</b></p> <p>Viti 2020</p>
--	--	--	------------------------	--	---





 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 2018 DATE RECEIVED: 2018			
Nr. i Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
06	47	1190	A

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrasnji Poslova  
Ministry of Internal Affairs

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit  
Nga z. Kujtim Gashi, Drejtor i Përgjithshëm i ASHI/MPB

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**


Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Titulli i auditimit: “Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike”

Nr.	Gjetja/titulli	Rekomandimi	Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit/Zyrtari/ët përgjegjës	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Koha/Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1.	ASHI-ja nuk ka strategji të miratuar për qeverisje elektronike për sektorin publik, <i>shih faqe 7.</i>	<p><b>Rekomandimi nr. 2</b></p> <p>Të siguroj se, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në koordinim me të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, duhet të hartojnë strategjinë për qeverisje elektronike dhe planin e veprimit për zbatim si dhe të përcaktojnë qartë objektivat dhe prioritetet strategjike. Kjo strategji duhet të shërbej si mjet për zvogëlimin e shpenzimeve, përmirësimin e shërbimeve, kursimin e kohës, kursimin e resurseve dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit në sektorin publik.</p>	DZHeQ dhe DRPA në ASHI-Selim Lulaj, Burim Balaj	<p>Hartimi dhe finalizimi i Draft-Strategjisë për e-Qeverisje;</p> <p>Hartimi dhe finalizimi i Planit të Veprimit;</p> <p>Përfundimi i procesit të konsultimeve dhe shkresave përcjellëse;</p> <p>Dërgimi për miratim në Qeveri.</p>	<p>Shtator 2020</p> <p>Shtator 2020</p> <p>Tetor 2020</p> <p>Nëntor 2020</p>

		<p><b>Rekomandimi nr. 3</b> Të siguroj që, mekanizmat monitorues të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit analizojnë në detaje arritjen e objektivave të strategjisë për qeverisje elektronike, si dhe të sigurohen që mekanizmat monitorues përpilojnë raporte përmbledhëse dhe analitike që tregojnë për rezultatet e arritura, ngecjet e identifikuar si dhe veprimet për korrigjimin e devijimeve për arritjen e objektivave të strategjisë;</p>	<p>DZHeQ në ASHI – Halim Thaqi</p>	<p>Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i njësisë përgjegjëse për monitorimin e Strategjisë për qeverisje elektronike.</p> <p>Përpilimi i raporteve të rregullta nga njësia përgjegjëse</p>	<p>Dhjetor 2021</p> <p>Raporte periodike</p>
2.	<p>ASHI ka vështirësi në përmbushjen e detyrave të saj dhe në plotësimin e pozitave profesionale, <i>shih faqe 10.</i></p>	<p><b>Rekomandimi nr. 4</b> Në koordinim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, duhet të plotësoj pozitën të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësisë që ka ASHI-ja, si dhe për arritjen e objektivave të qeverisjes elektronike.</p>	<p>DOQS- Gani Zogaj, DMIS- Hekrem Sadiku, (ASHI)</p>	<p>Inicimi procedurave të konkursit, nga njësitë përkatëse të ASHI-së, dhe adresimi i kërkesave në DASHC/MPB, për plotësimin e pozitave të lira në ASHI – hapja e konkurseve të rregullta.</p>	<p>Korrik – dhjetor 2020</p>

3.	ASHI-ja nuk bën monitorimin e duhur të IRK-ve për zbatimin e standardeve dhe politikave të TI-së dhe promovimin e shërbimeve, <i>shih faqe 11.</i>	<b>Rekomandimi nr. 5</b> Në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, krijon mekanizma për monitorimin e zbatimit të standardeve, politikave dhe procedurave të qeverisjes elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, si dhe të sigurohet që këta mekanizma hartojnë raporte mbi nivelin e zbatimit të këtyre standardeve, politikave dhe procedurave.	DZHeQ në ASHI - Halim Thaqi	Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i njësisë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të standardeve, politikave dhe procedurave të qeverisjes elektronike.  Përgatitja dhe dërgimi i pyetësorit tek IRK-të; Mbledhja e të dhënave nga institucionet;  Përgatitja e raportit mbi zbatimin e standardeve dhe politikave të TI-së nga IRK-të.	Dhjetor 2020  Shtator 2020 Tetor 2020-mars 2021 Qershor 2021
4.	IRK-të nuk kanë regjistra të plotë të projekteve dhe të investimeve që kanë bërë në fushën e TI-së, <i>shih faqe 13-14.</i>	<b>Rekomandimi nr. 16</b> Të sigurojnë regjistra të plotë të shpenzimeve dhe investimeve të bëra në fushën e teknologjisë së informacionit, për gjendjen ekzistuese dhe kërkesat e reja të nevojshme që ndihmojnë në arritjen e objektivave të organizatave.	DZHeQ në ASHI- Halim Thaqi	ASHI, referuar nenit 13 të Rregullores (QRK) nr. 06/2018 për Menaxhimin e Projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe Rekomandimit të ZKA, do të përgatis regjistrin e projekteve të realizuara nga institucionet e Republikës së Kosovës në fushën e TI-së.	Dhjetor 2020

 <b>REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO</b> ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PASIUA/UDREZUAR: DATUM PRILAZI/OSTAVLJEN: DATE RECEIVED/SUBMITTED:			
Nr. Njësia Org. Org. Jedrit Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. No./ Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.faqeve Dr. Stranica No. Pages
06	47	1791	3




DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVA CUSTOMS	
19.06.2020	DALJE - IZLAZ - PASSING
Nr. D/No: 01/525/2020	
Drejtoria Qendrore - Central Agency - Central Administration	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Financave  
 Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs  
 Zyra e drejtorit të përgjithshëm

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

REFERENCË:		Raporti Final- Organizimi dhe Menaxhimi I Investimeve te TI-së në Institucionet Publike				
PËR/ZA/TO:		Samir Zymberi-Udhëheqës Departamenti të Auditimit -ZKA				
CC:		Saranda Husaj Baraliu - Udhëheqëse e ekipit-ZKA				
PËRMES/PREKO/THROUGH:						
NGA/OD/FROM:		Ibrahim Xhaka-U.d. Drejtor i Përgjithshëm i DK 				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Plani i Veprimit -Raporti Final- "Organizimi dhe Menaxhimi I Investimeve te TI-së në Institucionet Publike"				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	Prishtinë	Data:	18/06/2020	
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:		
Room No.:		Extension:		Date:		
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/for action						
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/for approval						
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/for signature						
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/for comments						
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/may we discuss						
VËMENDJA JU AJ/ VASA PAZNJA/your attention						
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/as discussed						
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/as requested						X
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN						
PËR INFORMIMIN TU AJ/ZA VASU INFORMACIJU/for your information						
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE						



Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës.  
 Tel & Fax (+ + 381 38) 540 350 /540 836  
[www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

I nderuar

Ne kemi shqyrtuar dhe analizuar Raportin Final "Organizimi dhe Menaxhimi i Investimeve të TI-së në Institucionet Publike".

Gjithashtu ,dëshirojmë po ashtu të ju falënderojmë për punën profesionale qe ekipi juaj ka bërë gjatë auditimit si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm qe kanë pasur me zyrtarët doganor, për gjate tërë kohës.

Pasi që raporti ndërlidhë disa institucione si dhe Dogana është cituar në raport, ne kemi përgatitur Planin e Veprimit, si dhe masat që ne kemi ndërmarrë në lidhje me të gjeturën në Raportin Final.

Me respekt,  
**Ibrahim Xhaka**  
U. d Drejtor i Përgjithshëm  
Dogana e Kosovës





Nr.i Rekom.	Rekomandimi	Personat/Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit	Masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimit	Afati i zbatimit
1	<p>Dogana e Kosovës nuk ka hartuar dokument strategjik për teknologjinë e informacionit, e cila do të përcaktonte objektivat në funksion të arritjes së prioriteteve strategjike të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe standardet që kërkohen të plotësohen sipas udhërrëfyesit të Bashkimit Evropian (BE) për Doganën "Blueprint i BE-së". Mirëpo, Dogana e Kosovës ka hartuar Planin Strategjik 2016-2018 dhe Planin Strategjik 2019-2023 si dhe planin e aktiviteteve për zbatimin e strategjisë së Doganës së Kosovës. Disa objektiva dhe aktivitete të tyre janë të ndërlidhura me zhvillimin dhe avancimin e sistemeve informative si dhe të teknologjisë së informacionit. Po ashtu, nga vet-vlerësimi i bërë nga Dogana e Kosovës për "Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit" sipas udhërrëfyesit të BE-së për Doganën "Blueprint i BE-së" është gjetur që ka zbrasëtitira për shkak të mungesës së strategjisë së TI-së.</p>	<p>Departamenti i Sistemeve Doganore dhe Teknologjisë Informative.</p>	<p>Është krijuar draft Strategjia 2020 – 2025 e Doganës së Kosovës me të gjitha detajet e implementimit dhe aprovimi i saj pritet të behet shumë shpejtë.</p>	<p>Në fillim të muajit Korrik 2020.</p>

